



Kolegji Riininvest

Doracak për studentë

Departamenti i Shkencave Kompjuterike
Studimet Bachelor

TETOR, 2021

Fjala përshëndetëse nga UDHËHEQËSJA E PROGRAMIT

Të nderuar studentë, mirë se vini në Kolegjin Riinvest!

Arsimi që ofrohet në Kolegjin Riinvest synon që të ju ndihmojë secilit nga ju të zhvilloni aftësi për mendim kritik dhe logjik. Ne e kultivojmë shprehjen e lirë në mënyrë që ju t'i kuptoni dhe forconi aftësitë tuaja dhe të formoni një themel të fortë mbi të cilin do të jeni të gatshëm për tregun e punës apo të vazhdoni të ndërtoni edukimin tuaj të mëtutjeshëm.

Ne do ju ndihmojmë që përmes mësimnxënies së vazhdueshme të shkëlqeni në punën tuaj. Kjo metodë që ne e shfrytëzojmë është për të lehtësuar tranzicionin tuaj në mënyrë sa më efektive nga nxënës në student, gjë që është poashtu e domosdoshme për sukses të qëndrueshëm.

Ne kemi parasysh që fillimi i studimeve tuaja mund të ju përballë me një sërë sfidash mirëpo të gjitha do të përpiqemi t'i tejkalojmë së bashku në mënyrë efektive, duke komunikuar lirshëm, bashkëpunuar me njëri-tjetrin si dhe duke pasur vetëbesim në aftësitë e juaja që i keni fituar deri tani.

Gjate kësaj periudhe ne do të komunikojmë së bashku për të kuptuar koncepte të reja, ndërsa përmes punës praktike do t' i zbatojmë ato në jetën e përditshme industriale si dhe do të kultivojmë mësimnxënie të qëndrueshme, duke përfshirë vetëbesimin, vetërespektin, disiplinën dhe këmbënguljen për të arritur qëllimet dhe idealet.

Ju dëshirojmë suksese!

Albnora Hoti Krasniqi

Udhëheqëse e Programit

Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Softuerike (BSc.)

Personeli që mund të kontaktoni

Pozita	Emri	Email
Rektor	Armend Muja	armend.muja@riinvest.net
Dekan për Studime Themelore	Alban Zogaj	alban.zogaj@riinvest.net
U.D. Sekretare e Përgjithshme	Dorina Kralani	dorina.kralani@riinvest.net
Udhëheqëse e Departamentit të Shkencave Kompjuterike/Master/ Zyra e Mësimit	Albnora Hoti Krasniqi	albnora.hoti@riinvest.net
Koordinatore e Departamentit Menaxhim Biznesi	Rita Sekiraqa	rita.sekiraqa@riinvest.net
Udhëheqëse e Zyrës së Cilësisë dhe Zhvillimit Akademik/ Zyra Ndërkombëtare	Diandra Nela	diandra.nela@riinvest.net
Zyra e Financave	Besnik Zogaj Elirjeta Beka Shkëndie Loxha	besnik.zogaj@riinvest.net elirjeta.beka@riinvest.net shkendie.loxha@riinvest.net
Zyrtare e Zyrës së Marketingut	Allmedina Hoxha	allmedina.hoxha@riinvest.net
Zyrtare për Çështje Akadematike	Drenushë Murtezi Berisha	drenusha.murtezi@riinvest.net
Bibliotekare	Arta Bislimi	biblioteka@riinvest.net
Zyrtar për shërbime studentore	Shkëndie Loxha Hajdin Ujkani	shkendie.loxha@riinvest.net hajdin.ujkani@riinvest.net
Zyrtar i IT-së, e-learning dhe e-mail	Arnis Hasani	arnis.hasani@riinvest.net
Sistemi Informatik i Menaxhimit - MyRiinvest	Arnis Hasani	sim@riinvest.net

Informata tjera të rëndësishme:

Recepcioni:
Email:
webfaqja:

038 224 322; thirrje pa pagesë në 080023456
info@riinvest.net
www.riinvest-edu.net

PËRMBAJTJA

<i>Fjala përshëndetëse nga udhëheqësja e programit</i>	2
PERSONELI QË MUND TË KONTAKTONI	3
<i>Informata për Institucionin</i>	5
<i>Kolegji Riinvest</i>	5
<i>Informata për Programin</i>	7
<i>Si është i strukturuar programi i studimeve BSc Shkenca Kompjuterike – Inxhinieria Softuerike?</i>	7
<i>Cili është qëllimi i përgjithshëm i programit?</i>	7
<i>Rezultatet e përgjithshme të programit</i>	7
REZULTATET SPECIFIKE TË PROGRAMIT	8
<i>Informata për procedurat dhe shërbimet</i>	17
<i>Cilat janë procedurat e regjistrimit?</i>	17
<i>Si pajisem me ID?</i>	17
<i>A kam qasje në email zyrtar?</i>	17
<i>A kam qasje në profilin tim?</i>	17
<i>Çka është e-learning?</i>	17
<i>Si të menaxhoj financat?</i>	18
<i>Çfarë detyra ka Bibliotekari?</i>	18
<i>Çfarë është qasja në kompjuter?</i>	18
<i>Pijet dhe ushqimi?</i>	18
<i>Informata për Shërbime Shëndetësore</i>	18
<i>Aktivitetet studentore jashtë-mësimore</i>	19
<i>Çka duhet të bëj për të marrë diplomën?</i>	19
<i>Informata për procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit</i>	20
<i>Çka janë ECTS-të ?</i>	20
<i>A duhet të vi me rregull në ligjërata?</i>	20
<i>Për sa kohë duhet t'i përfundoj studimet?</i>	21
<i>A mund të pauzoj dhe të kthehem prapë për të vazhduar studimet?</i>	21
<i>Cila është qasja e mësimnxënies dhe mësimdhënies?</i>	21
<i>Çfarë aktivitetesh parashikohen në program?</i>	21
<i>Çfarë janë metodat e vlerësimit?</i>	22
<i>Cili është orari i vlerësimit?</i>	22
<i>Si vlerësohen lëndët?</i>	22
<i>Kur dorëzohen detyrat?</i>	23
<i>A duhet të gjitha detyrat të shkruhen me kompjuter?</i>	23
<i>Çfarë duhet të kem parasysh kur bëj një detyrë?</i>	23
<i>Si e dorëzoj detyrën?</i>	23
<i>Çfarë ndodhë nëse nuk e dorëzoj detyrën?</i>	23
<i>Kur marr rezultatet e vlerësimit?</i>	23
<i>Si i marr komentet në performancën time?</i>	23
<i>A pajisem me kopjen e vlerësimit?</i>	24
<i>Çfarë është sistemi i vlerësimit?</i>	24
<i>Çfarë ndodhë nëse nuk e kaloj lëndën?</i>	24
<i>Çka është Plagjiatura dhe Mashtrimi?</i>	24
<i>Çfarë ndodhë nëse konstatohet plagjiatura?</i>	25
<i>Çfarë ndodhë nëse konstatohet mashtrimi?</i>	25
<i>Kë duhet të kontaktoj kur kam ndonjë pyetje?</i>	25
<i>Si mund të ankojem?</i>	26
<i>A ka ndonjë mekanizëm për pjesëmarrjen e studentëve?</i>	26
<i>Si mund të bëj komentet për përvojën time në Kolegji?</i>	26
<i>Procedura e ankesave</i>	27
<i>Procedura për Plagjiaturë dhe Mashtrim</i>	28
RREGULLAT GJATË PROVIMEVE	29
<i>Kalendari Akademik 2021 – 2022</i>	30

Informata për Institucionin

Kolegji Riinvest

Kolegji Riinvest u themelua në vitin 2007 mbi traditën e pasur shumëvjeçare të Institutit për Hulumtime Zhvillimore Riinvest dhe nga një grup ekspertësh kosovarë të shkencave kompjuterike me punë dhe banim në Austri. Personeli akademik i Kolegjit Riinvest u zhvillua gjatë disa viteve në universitete evropiane e amerikane, e veçmas në Universitetin Staffordshire të Britanisë së Madhe.

Tash, me Kolegjin Riinvest janë të lidhur profesorët dhe ekspertët më të mirë nga fusha e shkencave ekonomike dhe shkencave kompjuterike, duke krijuar një bazë të fortë për studime ekonomike dhe të biznesit të nivelit bachelor dhe master.

Vizioni

Kolegji Riinvest do të jetë institucion i arsimit të lartë ndërmarrës dhe model në Kosovë dhe rajon, që bashkëshkrinë në mënyrë sinergjike arsimin cilësor, hulumtimin e punën praktike, duke krijuar një përvojë të veçantë akademike që kultivon kreativitetin, ndërmarrësinë dhe punësimin tek studentët. Do të ketë partneritete strategjike me biznese dhe universitete vendore e ndërkombëtare. Kolegji Riinvest do të jetë lider në formësimin e politikave, vendimmarrjes ekonomike dhe inovacioneve teknologjike dhe do të luajë rol aktiv në zhvillimet shoqërore.

Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë studime dhe hulumtime të cilësisë së lartë, në mënyrë që të sigurojmë ekspertë për të mirën e nevojave zhvillimore të Kosovës, me kapacitete për të garuar në nivel global. Ne qëndrojmë pas vlerave tona:

- *Kultivimi i kreativitetit, të menduarit kritik dhe inovacionit*
- *Toleranca*
- *Etika e lartë dhe ndershmëria*
- *Liria akademike*
- *Partneriteti dhe transparenca drejt palëve me interes, institucioneve dhe opinionit*
- *Identifikimi dhe pronësia me misionin, vizionin dhe vlerat tona nga personeli dhe studentët*

Si është i organizuar Kolegji Riinvest?

Qeverisja dhe Organet e Kolegjit Riinvest

Parimi qeverisës i Kolegjit Riinvest balancon nevojat për menaxhim modern, ndarjen e përgjegjësive ndërmjet Bordit, Këshillit Akademik dhe menaxhmentit administrativ-operacional dhe financiar.

Për çështjet akademike ekzistojnë dy nivele: niveli menaxherial dhe niveli i anëtarëve të kolegjit në kuadër të Këshillit Akademik dhe komiteteve programore.

- Bordi i Kolegjit Riinvest
- Këshilli Akademik
- Menaxhmenti

Udhëheqësi i departamentit është përgjegjës për procesin e mësimdhënies dhe hulumtimit në departament. Ai nxit dhe ndërmerr iniciativa për bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare dhe është përgjegjës për zhvillimin e programeve të studimit të cilësisë së lartë.

Udhëheqëse e Departamentit

Emri:	<i>Albnora Hoti Krasniqi</i>
E-mail:	<i>albnora.hoti@riinvest.net</i>
Telefoni:	<i>+ 381 38 224 322; thirrje pa pagesë në 0800 234 56</i>

Informata për Programin

Si është i strukturuar programi i studimeve BSc Shkenca Kompjuterike – Inxhinieria Softuerike?

Programi ofrohet me orar të plotë me kohëzgjatje prej tre vitesh (6 semestra) dhe me 180 ECTS (Kredi). Programi ka tri profile, ato janë:

1. Programimi për pajisje mobile dhe cloud
2. Menaxhimi i rrjetave dhe bazave të të dhënave
3. Siguria kibernetike

Të gjitha profilet janë të dizajnuara në përputhshmëri të plotë me programin. Studentët e të gjitha profileve, në vitin e parë mësojnë lëndët e njëjta, ndërsa në vitin e dytë, në semestrin e katërt fillon profilizimi, varësisht nga përcaktimi personal i studentëve, ku studentët thellohen dhe specializohen. Me përfundimin e këtij programi, studentët mund të vazhdojnë studimet Master në Kolegjin Riinvest ose në institucionet tjera vendore apo ndërkombëtare.

Cili është qëllimi i përgjithshëm i Programit?

Qëllimi i programit BSc në Shkenca Kompjuterike - Inxhinieria Softuerike është përgatitja e studentëve me njohuri të barabarta në zhvillimin e softuerit dhe Inxhinieri Softuerike. Gjithashtu, është avancimi i njohurive dhe shkathtësive të studentëve nga fusha e inxhinierisë softuerike si dhe të ju ofrojë një hyrje në kërkimet shkencore të inxhinierisë softuerike. Përpos kësaj, studentët inkurajohen dhe përkrahen në thellimin e rezonimit kritik në adresimin e sfidave të ardhshme në zhvillimin e sistemeve komplekse softuerike. Studentët do të jenë në gjendje të specifikojnë, modelojnë dhe dizajnojnë arkitekturat softuerike, si dhe të ofrojnë zgjidhje praktike për problemet në biznes, duke i aplikuar principet e inxhinierisë softuerike, të cilat do t'i mësojnë gjatë këtij programi. Për shkak se inxhinierët softuerikë kanë ndërlidhje me funksionet në biznes, si dhe me funksionin e programerit, ata duhet të trajnohen në shkathtësitë komunikuese, si dhe ato udhëheqëse, duke u angazhuar përmes kurseve individuale dhe atyre grupore.

Studimet janë të aplikuara. Modulet kanë aplikime praktike dhe gjatë mësimin përdoren kërkesat nga industria, duke zhvilluar IT projekte nga jeta e përditshme. Gjatë programit, studentët do të kenë qasje në biznese dhe do të marrim pjesë në disa IT projekte.

Ky program është unik në Kosovë sepse është i pari që koncentrohet në Inxhinieri Softuerike. Programi ofron disa kurse të cilat nuk ligjërohen në universitete të tjera në Kosovë.

Rezultatet e përgjithshme të Programit

Pas përfundimit të suksesshëm të programit, studenti do të jetë në gjendje të:

- ✓ Kuptojë, vlerësojë dhe aplikojë teknikat dhe metodat për të zgjidhur problemet e ndryshme, nga menaxhimi deri te zhvillimi i proceseve të ndryshme informatike;
- ✓ Bëjë vlerësimin dhe aplikimin e mjeteve të menaxhimit të projektit dhe teknikave përkatëse;

- ✓ Bëjë njohjen, vlerësimin dhe përdorimin e një serie gjuhësh programore, për të mundësuar zhvillimin e sistemeve të ndryshme informatike;
- ✓ Bëjë njohjen, vlerësimin dhe implementimin e metodave të zhvillimit të softuerit, për të mundësuar krijimin e sistemeve të ndryshme informatike;
- ✓ Bëjë njohjen, kuptimin dhe aplikimin e algoritmeve dhe strukturave të të dhënave, për të mundësuar realizimin më të suksesshëm të aplikacioneve të ndryshme;
- ✓ Bëjë njohjen dhe implementimin e metodave të ndryshme të testimit të softuerit dhe sigurimin e cilësisë maksimale të sistemeve të zhvilluara.

REZULTATET SPECIFIKE TË PROGRAMIT

PROFILI: Programimi për Pajisje Mobile dhe Cloud

Duke i përcjellë trendet aktuale në zhvillimin e teknologjisë informatike, vërehet një ekspansion i dukshëm i pajisjeve mobile. Këto pajisje kanë krijuar realitete të reja të cilat karakterizohen me kërkesa globale e lokale për sisteme aplikative. Pos nevojës për njohuri dhe shkathtësi nga Inxhinieria Softuerike, e cila është bazë e të gjitha studimeve në Shkencat Kompjuterike, qëndron konstatimi për nevojën për specializim në lëminë e programimit për pajisje mobile dhe sistemet cloud. Pjesa gjithnjë më e madhe e industrisë, po i zhvillojnë ose po i përcjellin shërbimet e tyre edhe në pajisje mobile, me ç'rast është paraqitur kërkesë e shtuar për ekspertë të zhvillimit dhe bartjes së aplikacionit për pajisjet mobile. Në anën tjetër, sistemet e bazuara në konceptet cloud po shtohen nga dita në ditë. Mundësia e krijimit të aplikacioneve cilësore të cilat po i kursejnë konsumatorët nga problemet e administrimit, mirëmbajtjes së harduerit e softuerit, po bëhen gjithnjë e më atraktive.

Me profilin Programimi për pajisje mobile dhe cloud, studentët do të aftësohen për zhvillimin e aplikacioneve për adaptimin e sistemeve ekzistuese nga ueb dhe desktop në ato mobile, si dhe platforma kolaboruese mes desktop, ueb dhe mobile. Gjithashtu studentët do të njohohen me sistemet cloud, si ndërtohen, si përdoren në mënyrë efektive dhe si zhvillohen ato.

Studentët këtu do të mund të specializohen duke i përcjellur ligjëratat dhe duke zhvilluar projekte reale nga jeta e përditshme, nga 50% të lëndëve. Lëndët unike janë: Sistemet Operative për pajisjet mobile, Programimi për pajisjet mobile dhe Aplikacionet globale për cloud. Gjithashtu, në lëndët Projekti TI-1, 2 e 3 fokusi i projekteve do të jetë në aplikacionet mobile.

Pas diplomimit, studentët do të jenë në gjendje të:

- ✓ Kuptojnë, vlerësojnë dhe të aplikojnë teknikat dhe metodat për të zgjidhur problemet e ndryshme, nga menaxhimi deri te zhvillimi i proceseve të ndryshme informatike / softuerike;
- ✓ Kuptojnë kërkesat dhe adaptojnë kodin e aplikacionit, sipas algoritmeve të reja dhe strukturave të të dhënave për nevojat e reja të klientit;
- ✓ Bëjnë njohjen, kuptimin dhe aplikimin e pjesëve apo të tërë ciklit softuerik (kërkesat, arkitektura, dizajni, zhvillimi, testimi, implementimi, përkrahja) për të mundësuar realizimin më të suksesshëm të aplikacioneve të ndryshme;
- ✓ Bëjnë zgjidhjen e problemeve teknike mobile;
- ✓ Bëjnë kodim të softuereve me kërkesa të ndryshme, duke përdorur disa gjuhë programore dhe algoritme / teknika të ndryshme;
- ✓ Të dizajnojnë dhe zhvillojnë ueb – pajisje mobile, duke testuar korrektësinë e shfrytëzimit;
- ✓ Bëjnë zhvillim të softuerit për sisteme interaktive të sigurta;
- ✓ Punojnë individualisht apo të jenë pjesë e ekipit.

Disa nga shkathtësitë e fituara do të jenë:

- ✓ Dizajnimi i “User Interface” të përshtatshme për të gjitha rolet e shfrytëzuesit dhe duke testuar korrektësinë e shfrytëzimit;
- ✓ Krijimi i logjikës së rrjedhjes së aplikacionit;
- ✓ Zhvillimi i mendimit kritik;
- ✓ Vlerësimi i madhësisë së projektit;
- ✓ Përfitimi i eksperiencës në zhvillimin e aplikacioneve për pajisje mobile;
- ✓ Monitorimi i performancës së softuerit.

VITI I			
Semestri 1			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Hyrje në informatikë	6	Obligative
2	Matematikë për shkencë kompjuterike 1	6	Obligative
3	Arkitekturë e kompjuterëve	6	Obligative
4	Anglisht për biznes 1	6	Zgjedhore
5	Bazat e programimit	6	Obligative
Semestri 2			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Algoritme dhe struktura të të dhënave	6	Obligative
7	Programimi në C#	6	Obligative
8	Teknologjia e internetit	6	Obligative
9	Sisteme operative	6	Obligative
10	Matematikë për shkencë kompjuterike 2	6	Obligative

VITI II			
Semestri 3			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Bazat e të dhënave	6	Obligative
2	Rrjetat kompjuterike	6	Obligative
3	Programimi i orientuar në objekte	6	Obligative
4	Inxhinieria softuerike	6	Obligative
5	Siguria e të dhënave	6	Obligative
Semestri 4			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Programimi në web	6	Obligative
7	Sistemet e shpërndara	6	Obligative
8	Projekti i TI-së 1	6	Obligative
9	Menaxhimi i projekteve	6	Obligative
10	Kursi zgjedhor nga profili përkatës	6	Zgjedhore

Programimi për Pajisje Mobile dhe Cloud (MOBCL)

VITI III			
Semestri 5			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Programimi në JAVA	6	Obligative
2	Testimi i Softuerit	6	Obligative
3	Projekti i TI-së 2	6	Obligative
4	Lëndë zgjedhore nga profili MOBCL	6	Zgjedhore
5	Lëndë zgjedhore e përgjithshme	6	Zgjedhore
Semestri 6			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Projekti i TI-së 3	6	Obligative
7	Diploma	12	Obligative
8	Hyrje në Inteligjencë Artificiale	6	Obligative
9	Lëndë zgjedhore nga profili MOBCL	6	Zgjedhore

Nr.	Lëndët	ECTS
1	Sistemet Operative për Pajisjet Mobile	6
2	Programimi për Pajisje Mobile	6
3	Aplikacionet Cloud – Globale	6

Lista e lëndëve zgjedhore për profilin: Programimi për Pajisje Mobile dhe Cloud (MOBCL)

PROFILI: Menaxhimi i Rrjetave dhe Bazave të të Dhënave

Sistemet Softuerike janë shtylla e bizneseve moderne. Këto sisteme janë komplekse dhe zhvillimi i tyre kërkon një kompetencë të madhe, gjë që shton nevojën për të pasur ekspertë nga lëmi të kombinuara të inxhinierisë softuerike. Nga analiza e vërejtjeve të komunitetit të TIK dhe komuniteti i ndërmarrjeve zhvilluese të softuerëve, është e dukshme kërkesa për personelin me specializim të proceseve, aftësi të dizajnit, shkathtësi të administrimit dhe njohje më të detajuar të bazave të të dhënave, të kombinuar me rrjetat kompjuterike. Prandaj, me ngritjen e nivelit të shërbimeve informatike është ngritur nevoja për specialist të Menaxhimit të Rrjetave dhe Bazave të të Dhënave.

Duke studiuar Rrjetat dhe Bazat e të dhënave në Kolegjin Riinvest, studentët do të mbledhin njohuri konkrete të nevojshme për të administruar, dizajnuar, menaxhuar dhe për të zhvilluar me sukses çdo projekt kompleks softuerik. Kjo arrihet përmes aplikimit të metodave të avancuara në mësim dhe ndërlidhjes së fuqishme të teorisë me problemet praktike. Studentët do të kenë mundësi të angazhohen në zhvillimin e projekteve praktike inovative, me qëllim të aplikimit të menjëhershëm në praktikë të teknikave dhe metodave teorike dhe të kreativitetit të tyre. Kjo do të garantojë një perspektivë të madhe në potencialin e tyre për punësim në projekte të vogla e të mëdha, në çdo kompani të vendit dhe të huaj. Gjithashtu, studentët që përfundojnë këtë drejtim do të jenë të përgatitur për të vazhduar me sukses me studimet për master në Inxhinierinë Softuerike, në Kolegjin Riinvest apo në universitete të njohura botërore.

Këtu studenti thellohet më shumë në strukturat, procedurat, konceptet dhe administrimin e Sistemeve të Bazave të të dhënave. Ata do të njoftohen me konceptet e Data Warehousing, Big Data, Data Mining. Temat si Advanced SQL, administrator i bazës së të dhënave, si dhe Data Warehouse & Data Mining janë koncepte të cilat e bëjnë një inxhinier të aftë të thellohet më detajisht në zgjidhjen e problemeve komplekse nga aspekti i bazës së të dhënave. Këto do të kombinohen me temat si Dizajnimi i rrjetave, Ndërtimi i rrjetave, Konfigurimi i tyre, Mbrojtja nga sulmet dhe monitorimi, Analiza e Performancës dhe optimizimi, si dhe Menaxhimi i rrjetit.

Gjithashtu, zhvillimi i projekteve në lëndët Projekti TI 1, 2 e 3 do të fokusohet kryesisht në rrjetat dhe bazat e të dhënave.

Pas diplomimit, studentët do të jenë në gjendje të:

- Dizajnojnë, zhvillojnë, testojnë, implementojnë, përmirësojnë dhe administrojnë bazën e të dhënave të cilësdo platformë, të vendosur në rrjet lokal, cloud apo të shpërndarë në shumë rrjete;
- Dizajnojnë, implementojnë, mirëmbajnë rrjetat dhe sistemet e komunikimit të të dhënave, duke përfshirë edhe rrjetat me dhe pa tela, extra apo intra-net;
- Analizojnë kërkesat e klientit dhe të zhvillojnë resurse të të dhënave, për të ruajtur dhe gjeneruar informatat kritike në kohë më të shkurtër;
- Vlerësojnë sisteme softuerike të shpërndara në rrjete dhe baza të të dhënave të ndryshme dhe të veprojnë në modifikimin e softuerit ekzistues të tërë sistemit, me theks në bazë të të dhënave dhe rrjete;
- Punojnë për të gjitha llojet e organizatave me standarde më të larta, për të siguruar të dhënat si sigurimi, bankat, kompanitë dhe ofruesit e përmbajtjes;
- Bëjnë njohjen dhe implementimin e metodave të ndryshme të testimit të softuerit, optimizimin të rrjetit dhe bazave të të dhënave dhe sigurimin e cilësisë maksimale;
- Punojnë individualisht apo të jenë pjesë e ekipit.

Disa nga shkathtësitë e fituara do të jenë:

- Dizajnimi i User Interface të përshtatshëm për të gjitha rolet e shfrytëzuesve dhe testimi i korrektësisë së shfrytëzimit;
- Krijimi i zgjidhjes nga aspekti i inxhinierisë softuerike dhe identifikimi nëse problemi mund të korrigojë në bazat e të dhënave apo në rrjet;
- Organizimi i informatave për sistemet që janë si përdorues, si dhe krijimi i mundësisë që ato të jenë “user-friendly” për klientët, vizitorët e internetit dhe kolegët;
- Kontrollimi i qasjes për klientët dhe punonjësit dhe krijimi i sigurisë së sistemeve;
- Parandalimi i humbjes së të dhënave;
- Monitorimi i ngarkesës së rrjetit dhe bazës së të dhënave dhe aplikimi i hapave për optimizimin e tyre;
- Rikthimi i të dhënave të humbura për klientët.

VITI I

Semestri 1

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Hyrje në informatikë	6	Obligative
2	Matematikë për shkencë kompjuterike 1	6	Obligative
3	Arkitekturë e kompjuterëve	6	Obligative
4	Anglisht për biznes 1	6	Zgjedhore
5	Bazat e programimit	6	Obligative

Semestri 2

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Algoritme dhe struktura të të dhënave	6	Obligative
7	Programimi në C#	6	Obligative
8	Teknologjia e internetit	6	Obligative
9	Sisteme operative	6	Obligative
10	Matematikë për shkencë kompjuterike 2	6	Obligative

VITI II

Semestri 3

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Bazat e të dhënave	6	Obligative
2	Rrjetat kompjuterike	6	Obligative
3	Programimi i orientuar në objekte	6	Obligative
4	Inxhinieria softuerike	6	Obligative
5	Siguria e të dhënave	6	Obligative

Semestri 4

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Programimi në web	6	Obligative
7	Sistemet e shpërndara	6	Obligative
8	Projekti i TI-së 1	6	Obligative
9	Menaxhimi i projekteve	6	Obligative
10	Kursi zgjedhor nga profili përkatës	6	Zgjedhore

Menaxhimi i Rrjetave dhe Bazave të të Dhënave (DBNTM)

VITI III			
Semestri 5			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Testimi i Softuerit	6	Obligative
2	Projekti i TI-së 2	6	Obligative
3	Lëndë zgjedhore nga profili DBNTM	6	Obligative
4	Lëndë zgjedhore nga profili DBNTM	6	Zgjedhore
5	Lëndë zgjedhore e përgjithshme	6	Zgjedhore
Semestri 6			
Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Diploma	12	Obligative
7	Hyrje në Inteligjencë Artificiale	6	Obligative
8	Lëndë zgjedhore nga profili DBNTM	6	Obligative
9	Lëndë zgjedhore nga profili DBNTM	6	Zgjedhore

Lista e lëndëve zgjedhore për profilin: Menaxhimi i Rrjetave dhe Bazave të të Dhënave (DBNTM)

Nr.	Lëndët	ECTS
1	Bazat dhe SQL i Avancuar	6
2	Menaxhimi i Rrjetave	6
3	Administrimi i Bazave të të Dhënave	6
4	Dizajni i Rrjetave	6
5	Siguria e Rrjetave	6
6	"Data Warehouse and Data Mining"	6
7	Siguria në Rrjetat Komunikuese	6

PROFILI: Siguria Kibernetike

Rritja e shkallës së dixhitalizimit në organizata dhe biznese, sidomos në banka komerciale, ka rritur njëkohësisht edhe shkallën e ekspozimit ndaj sulmeve kibernetike. Sulmet e ndryshme ku të dhënat mund të merren pa lënë gjurmë të detektueshme, janë bërë pjesë e jetës së përgjithshme të dixhitalizuar dhe dinamike. Si pasojë, bankat dhe bizneset tjera duhet të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme që të ulin riskun që iu kanoset nga sulmet kibernetike gjithnjë në rritje. Siguria kibernetike e bizneseve, si dhe ajo personale, është një fushë në rritje e cila meriton një drejtim të veçantë që tani ofrohet nga Kolegji Riinvest.

Ky profil e adreson kërkesën e tregut kosovar për të pasur kapacitete njerëzore në këtë fushë, të formësuara në arsimin e lartë. Profili Siguria Kibernetike ofron program me nën-specializim në Sigurinë e rrjetave, Sigurinë e të dhënave, Sigurinë e aseteve harduerike dhe softuerike. Studentët do të fokusohen në teknikat e mbrojtjes nga sulmet kibernetike, analizën e sulmeve, mbrojtjen e rrjetave kompjuterike dhe të dhënave sensitive, etj.

Studentët do të mësojnë për sigurinë kibernetike duke u përqendruar në sigurinë e rrjetave dhe sigurinë e të dhënave. Studentët gjithashtu do të mësojnë të krijojnë aplikacione të sigurta, si dhe teknikat e ndryshme të sulmeve dhe mbrojtjes së rrjetave kompjuterike. Studentët e diplomuar nga ky drejtim do të mund të punësohen në organizata dhe biznese të ndryshme, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës, pasi që kërkesa për të diplomuar në këtë fushë është shumë e madhe. Studentët do të kenë rastin që gjatë studimeve të punojnë në platforma të ndryshme.

Pas diplomimit studentët do të jenë në gjendje:

- Analizojnë softuerin dhe rrjetat në aspektin e sigurisë, si dhe të identifikojnë dobësitë e tyre;
- Zhvillojnë aplikacione të sigurta;
- Mbrojnë rrjetat dhe aplikacionet nga sulmet kibernetike;
- Krijojnë kushtet e nevojshme për ruajtjen e infrastrukturës harduerike dhe softuerike nga sulmet e ndryshme kibernetike.

VITI I

Semestri 1

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Hyrje në informatikë	6	Obligative
2	Matematikë për shkencë kompjuterike 1	6	Obligative
3	Arkitekturë e kompjuterëve	6	Obligative
4	Anglisht për biznes 1	6	Zgjedhore
5	Bazat e programimit	6	Obligative

Semestri 2

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Algoritme dhe struktura të të dhënave	6	Obligative
7	Programimi në C#	6	Obligative
8	Teknologjia e internetit	6	Obligative
9	Sisteme operative	6	Obligative
10	Matematikë për shkencë kompjuterike 2	6	Obligative

VITI II**Semestri 3**

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Bazat e të dhënave	6	Obligative
2	Rrjetat kompjuterike	6	Obligative
3	Programimi i orientuar në objekte	6	Obligative
4	Inxhinieria softuerike	6	Obligative
5	Siguria e të dhënave	6	Obligative

Semestri 4

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Programimi në web	6	Obligative
7	Sistemet e shpërndara	6	Obligative
8	Projekti i TI-së 1	6	Obligative
9	Menaxhimi i projekteve	6	Obligative
10	Kursi zgjedhor nga profili përkatës	6	Zgjedhore

Siguria kibernetike

VITI III**Semestri 5**

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
1	Programimi me JAVA	6	Obligative
2	Testimi i softuerit	6	Obligative
3	Projekti i TI-së 2	6	Obligative
4	Lëndë zgjedhore nga profili CYBER	6	Zgjedhore
5	Lëndë zgjedhore e përgjithshme	6	Zgjedhore

Semestri 6

Nr.	Lëndët	ECTS	Tipi
6	Projekti i TI-së 3	6	Obligative
7	Diploma	12	Obligative
8	Hyrje në Inteligjencë Artificiale	6	Obligative
9	Lëndë zgjedhore nga profili CYBER	6	Zgjedhore

Lista e lëndëve zgjedhore për profilin: Siguria kibernetike

Nr.	Lëndët	ECTS
1	Hyrje në Sigurinë Kibernetike	6
2	Siguria e Rrjetave	6
3	Siguria e Sistemeve Operative	6
4	Protokolet e Avancuara & Siguria e Rrjetave	6

Informata për procedurat dhe shërbimet

Cilat janë procedurat e regjistrimit?

Studenti/ja regjistron vitin/semestrin e parë me rastin e regjistrimit në studimet Bachelor. Pas nënshkrimit të kontratës dhe me regjistrimin e tyre, studentit/es i sigurohet karta e identifikimit të studentit, e-mail adresa, qasja në e-learning, qasja në SIM (Sistemin Informativ të Menaxhmentit) dhe bibliotekë, si dhe në burimet tjera për studim dhe përkrahje. Studentët obligohen të bëjnë regjistrimin e viteve 2 dhe 3, më së voni 2 ditë para fillimit të semestrit. Regjistrimi i semestrit bëhet duke nënshkruar formularin e regjistrimit të vitit akademik dhe duke dorëzuar fletëpagesën për këstin e radhës, sipas planit të pagesave. Formulari për regjistrimin e vitit gjendet tek Zyra për Shërbime Studentore.

Si pajisem me ID?

Studenti/studentja do të pajiset me ID para fillimit të vitit akademik. Për këtë do të njoftoheni nga Zyra për Shërbime Studentore. Stafi ynë do të ju fotofrtojë dhe do të ju pajisë me ID kartën. ID është dokumenti juaj identifikues në kolegji dhe duhet ta mbani me vete, e sidomos e përdorni për qasje në bibliotekë dhe në provime.

Për ID mund të kontaktoni: arnis.hasani@riinvest.net

A kam qasje në email zyrtar?

Me rastin e regjistrimit, ju do të pajiseni me emailin zyrtar. Emaili juaj zyrtar përmban inicialet e emrit dhe mbiemrit dhe numrin tuaj të ID-së. Njëkohësisht, do të ju ofrohet fjalëkalimi i përkohshëm, të cilin ju më pas e ndërroni me qasjen tuaj të parë në këtë email.

Për çdo informatë shtesë ose probleme me emailin zyrtar mund të kontaktoni: arnis.hasani@riinvest.net

A kam qasje në profilin tim?

Pas regjistrimit në kolegji, ju keni të drejtë të kyçeni në Sistemin Informatik të Menaxhmentit (SIM). Në SIM ju mund të zhvilloni CV-në tuaj, të cilën mund ta përdorni me rastin e aplikimeve për punë ose për praktikë, si dhe të shihni syllabuset e lëndëve dhe notat tuaja. Qasja në SIM zakonisht bllokohet automatikisht nëse nuk përfundoni pagesat sipas planit tuaj të pagesave.

Për qasje në SIM mund të kontaktoni: sim@riinvest.net ose arnis.hasani@riinvest.net

Çka është e-learning?

E-learning është platformë e cila përdoret nga mësimdhënësi për të vendosur materialet e mësimin (ligjërata dhe ushtrime) dhe detyrat. Në e-learning mësimdhënësi poashtu mund të nxis diskutime, të parashtrojë kuize dhe të ofrojë lajmërimë. Studenti, sipas instruksioneve të mësimdhënësit, mund të dorëzojë detyrat në e-learning. Ju do të pajiseni me emër të përdoruesit dhe fjalëkalimin. Ju jeni të obliguar të shfrytëzoni platformën E-learning.

Qasja në E-learning zakonisht bllokohet automatikisht nëse nuk përfundoni pagesat sipas planit tuaj të pagesave.

Për qasje në e-learning mund të kontaktoni: arnis.hasani@riinvest.net

Si të menaxhoj financat?

Me rastin e regjistrimit, ju përcaktoni mënyrën e financimit. Zyra për Shërbime Studentore ju njofton për ofertat për studentë.

Përmbajuni kushteve dhe afateve të pagesës dhe nëse keni probleme, kontaktoni Zyrën për Shërbime Studentore.

Kontakti juaj për çështje financiare është me zyrtarët e financave: finance.admin@riinvest.net; shkendie.loxha@riinvest.net dhe elirjeta.beka@riinvest.net ose në telefonin +383 45 245 934 apo në telefonin pa pagesë 0800 23456.

Çfarë detyra ka Bibliotekari?

Detyra e bibliotekarit është të ofrojë në huazim dhe të pranojë në kthim librat në bibliotekë. Poashtu, bibliotekari ka për obligim të njoftojë studentët për koleksionet e ndryshme dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Biblioteka funksionon në kuadër të disa rregulloreve të cilat ndaras nga ky dokument, gjenden edhe në webfaqen e Kolegjit Riinvest, ku ju poashtu keni edhe doracakun e përdorimit të Bibliotekës.

Kontakti për bibliotekën është në email adresën: biblioteka@riinvest.net ose në numrin pa pagesë 0800 23456.

Çfarë është qasja në kompjuter?

Kolegji Riinvest ka laboratorë me kompjuterë për shfrytëzim të studentëve. Të gjithë kompjuterët kanë Internet, si dhe qasje në WiFi për t'u kyçur nga mjete të tjera.

Pijet dhe ushqimi?

Pijet dhe ushqimi ofrohen edhe në byfenë e kolegjit. Ushqimi nuk lejohet në mësim. Pijet me kapak lejohen në klasa dhe bibliotekë.

Informata për Shërbime Shëndetësore

Studentët duhet të paraqesin problemet mjekësore të veçanta nëse i kanë ato me rastin e regjistrimit. Në afërsi të lokacionit ndodhet shtëpia e shëndetit, në të cilën ofrohen shërbime shëndetësore për qytetarë.

Zyra për shërbime studentore

Në zyrën për Shërbime Studentore, ju mund të merrni të gjitha informatat për çështje administrative. Zyra për Shërbime Studentore është e obliguar të marrë kërkesat tuaja dhe t'i trajtojë ato në pajtim me rregulloren dhe procedurat e punës së Kolegjit Riinvest. Zyra për Shërbime Studentore mirëmban dosjet fizike dhe elektronike të studentëve në pajtim me rregulloren dhe procedurat e punës së Kolegjit Riinvest dhe Ligjin për ruajtjen e të dhënave personale. Kjo zyre ju njofton lidhur me të gjitha informatat e rëndësishme administrative në Kolegji. Është me rëndësi që për çështjet në vijim të drejtoheni tek administratori përkatës:

Regjistrimi i vitit akademik

Dorëzimi i pagesave

Paraqitja e provimeve

Pranimi i vërtetimeve për studentë

Pranimi i transkriptës së notave

Për shërbime studentore mund të kontaktoni me hajdin.ujkani@riinvest.net apo shkendie.loxha@riinvest.net

Aktivitetet studentore jashtë-mësimore

Aktivitetet jashtë-mësimore organizohen nga vetë studentët në Unionin e tyre. Studentët duhet të propozojnë aktivitetet e tyre vjetore për përkrahje nga Kolegji Riinvest.

Aktivitetet studentore jashtë-mësimore

Aktivitetet jashtë-mësimore organizohen nga vetë studentët në Unionin e tyre. Studentët duhet të propozojnë aktivitetet e tyre vjetore për përkrahje nga Kolegji Riinvest.

Çka duhet të bëj për të marrë diplomën?

Për të diplomuar studenti duhet:

Të përfundojë të gjitha provimet dhe praktikën, nëse ajo parashihet në program para diplomimit;

Të kryejë të gjitha pagesat për studime;

Përgatitja e diplomës zgjatë deri në 30 ditë nga paraqitja e kërkesës për diplomë;












Pas përfundimit të të gjitha këtyre obligimeve, studentët duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim duke plotësuar formularin i cili gjendet në Zyrën për Shërbime Studentore.

Informata për procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit

Çka janë ECTS-të ?

Programi është strukturuar në atë mënyrë që secili semestër ka module që përbëjnë 30 ECTS kredi. Pra, një vit akademik ka 60 ECTS kredi dhe i gjithë programi ka 180 kredi. Kredia nënkupton ngarkesën e studentit për lëndën e caktuar, duke përfshirë ligjëratat, ushtrimet, studimin në shtëpi, përgatitjen e detyrave, etj. Llogaritet që studenti i rregullt të ketë angazhim 8 orë në ditë për mësim, nëse ai e bën këtë në mënyrë sistematike. Prandaj, ligjëratat dhe ushtrimet organizohen në atë mënyrë që t'i mundësojnë studentit mësimin sistematik dhe gradual.

Shembull i llogaritjes së kredive në lëndën Programimi i Orientuar në Objekt:

Aktiviteti	Nr i orëve për Aktivitetin	
Ligjerata:	30	
Ushtrime:	30	
L+U:	60	
Seminar/praktikë:	20	
Studim i vazhdueshem:	44	
Përgatitja e Provimit:	20	
Pjesëmarrja në teste:	4	
Pjesëmarrja në provimin final:	2	
Me profesorin dhe asistentin:	10	
Total ORE:	160	
ECTS:	6	

A duhet të vi me rregull në ligjerata?

Rregullorja e studimeve i obligon studentët t'i vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet në Kolegjin Riinvest. Dënimi pasues nga mospjesëmarrja në këto orë mësimore përcaktohet nga syllabuset e lëndëve përkatëse, si dhe në kontratën e studentit.

Pjesëmarrja me rregull në ligjërata lehtëson mësimnxënien dhe i mundëson studentit të bëjë pyetje, diskutojë dhe sqarojë konceptet me mësimdhënësit dhe kolegët. Pjesëmarrja aktive poashtu lehtëson arritjen e rezultateve sepse me kryerjen e detyrave dhe mësimin sistematik, studenti më lehtë përgatitet për lëndën se sa kur mëson vetëm në shtëpi. Në rast të problemeve me pjesëmarrjen në ligjëratat, ju duhet të kontaktoni udhëheqësin e programit dhe të merrni leje.

Gjenerale	Adresa	Plai i pagesave	Notat	CV	
Notat					
Semestri 1					
Kodi i Lëndës	Emri i Lëndës	Emri i Lëndës së transferuar	Pjesëmarrja		Lloji
			L	U	
EKM0001	Metoda Kërkimore 1		100%		○
EKOM102	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore		80%		○
EKOM103	Teoria dhe Praktikat e Menaxhmentit		100%	100%	○

Për sa kohë duhet t'i përfundoj studimet?

Koha e lejuar për përfundim të studimeve është 6 vite prej momentit kur keni filluar, duke llogaritur pauzat dhe përsëritjet, përveç nëse ndërpreni studimet për një kohë më të gjatë. Afati i rregullt i përfundimit të studimeve është 3 vite, ndërkaq nëse studenti/ja nuk arrin të përfundojë studimet brenda afatit të rregullt, atij/asaj i ofrohet mundësia e tejkallimit të këtij afati deri në dyfishin e tij (6 vite). Megjithatë, studenti/ja që nuk diplomon brenda afatit të rregullt të studimeve ngarkohet financiarisht. Për detaje rreth obligimit financiar, ju mund të kontaktoni me zyrën e financave, kontakti i të cilëve gjendet në fillim të këtij doracakut.

Regjistrimi i vitit vijues bëhet në periudhën shtator –tetor të secilit vit.

A mund të pauzoj dhe të kthehem prapë të vazhdoj studimet?

Ne shpresojmë që ju do të përfundoni studimet me kohë. Mirëpo, nëse për arsye të ndryshme ju duhet të tërhiqeni apo të pauzion, ju mund të vazhdoni studimet më vonë. Rregullorja e studimeve BA/BSc në mënyrë specifike e përcakton se kur lejohet pauzimi, më konkretisht shihni nenin 19. Pauzimi i studimeve me miratimin e administratës quhet i justifikuar dhe nuk llogaritet në vitet e përsëritura. Çdo ndërprerje e pamiruar e studimeve është e barasvlershme me mosparaqitjen në procesin mësimor dhe viti llogaritet në përsëritje. Prosesi i pauzimit të studimeve në Kolegjin Riinvest, rregullohet me anë të rregullores për studime BA/BSc e cila gjendet në këtë link:

https://riinvest-edu.net/Uploads/Regulations/6/Rregullorja-e-Studimeve-BA_BSc.pdf.

Për pauzim të studimeve, studentët duhet të plotësojnë formularin për pauzim i cili gjendet tek Zyra për Shërbime Studentore. Rikthimi i studentit, pas ndërprerjes së justifikuar të studimeve, bëhet më së voni 2 ditë para fillimit të çdo semestri.

Si mund të tërhiqem nga studimet?

Studenti mund të parashtojë kërkesën me shkrim për tërheqje nga studimet dhe ta dorëzojë të nënshkruar tek zyrtari për shërbime studentore. Kërkesa, së bashku me dosjen e studentit, dërgohet në zyrën ligjore për të marrë vendimin. Vendimi për tërheqje nuk mund të merret deri në momentin kur student i përfundon të gjitha obligimet financiare ndaj institucionit, bazuar në kontratën dhe rregulloret në fuqi. Referuar kontratës për vitin akademik 2021/22, student i në rast të tërheqjes gjatë studimeve, duhet të paguajë shumën sipas nenit 13, paragrafi 1, referuar kontratës. Në afat prej 5 ditëve zyra ligjore merr vendimin. Për tërheqje nga studimet, studentët duhet të plotësojnë formularin për tërheqje i cili gjendet tek Zyra për Shërbime Studentore.

Cila është qasja e mësimnxënies dhe mësimdhënies?

Qasja e mësimdhënies dhe mësimnxënies merr parasysh nevojat e studentit për punë në klasë dhe në shtëpi. Shumica e lëndëve përdorin strategji si ligjëratat, ushtrimet dhe konsultimet si orë kontaktuese me studentët. Strategjitë tjera që aplikohen në klasë apo edhe në shtëpi janë: diskutimet, puna grupore, aktrimi i roleve, simulimi, punëtoritë, seminarët, vizitat dhe puna laboratorike. Informatat më të hollësishme gjenden në syllabuset e lëndëve.

Çfarë aktivitësh parashikohen në program?

Përderisa strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënies që përdoren nga personeli i Kolegjit Riinvest do të jenë në pajtim me ato të specifikuara nga përshkruesit e moduleve, duke pasur parasysh traditën arsimore në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë në akumulimin e njohurive më parë se në ndërtimin e shkathtësive dhe të nxënies e pavarur. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet të nxënies aktiv dhe zhvillimit të shkathtësive të studentëve në fushat në vijim:

Kreativitet

Mendim Kritik

Puna grupore

Hulumtimi dhe referenca

Çfarë janë metodat e vlerësimit?

Metodat e vlerësimit janë të lidhura drejtpërdrejtë me rezultatet e pritura që janë paraqitur më poshtë dhe marrin parasysh stilet e ndryshme të mësimin dhe inteligjencës, si dhe informatat dhe teknologjinë kyçe. Prandaj, strategjitë e vlerësimit përfshijnë provimet, prezantimet, punimet me shkrim dhe portfolio.

Cili është orari i vlerësimit?

Vlerësimi i moduleve do të mbahet normalisht gjatë semestrit, për teste, detyra dhe projekte, me provimin final në fund të çdo semestri. Shumica e moduleve në programet tona kanë një afat të mesëm gjatë javës së 6, 7 dhe 8 dhe provimin final. Disa module zbatojnë strategji të detyrave apo portfoliove. Detaje të strategjive të vlerësimit mund të gjenden në syllabuset e lëndëve.

Kolegji Riinvest organizon tri afate të rregullta (R) dhe dy afate plotësuese kompensuese (K).

Afati	Tipi	Semestri
Janar	R	1, 2, 3, 4, 5, 6
Prill	K	1, 2, 3, 4, 5, 6
Qershor	R	1, 2, 3, 4, 5, 6
Shtator	R	1, 2, 3, 4, 5, 6
Nëntor	K	1, 2, 3, 4, 5, 6

Datat e provimeve dërgohen në email.

Si vlerësohen lëndët?

Puna e vlerësuar për një modul duhet të vlerësohet nga mësimmshënësit në Kolegjin Riinvest, duke e dorëzuar këtë brenda dy javësh. Të gjitha detyrat dhe testet mbahen për një vit akademik. Nëse studentët nuk vijojnë një test apo nuk e dorëzojnë ndonjë detyrë, ata duhet ta ri-vijojnë atë. Çdo detyrë vlerësohet deri në 100% dhe kalkulohet në fletën e vlerësimit në bazë të peshës së saj. Përqindja e përgjithshme e përbën notën përfundimtare. Pesha e përqindjes së detyrës ofrohet në secilin modul. Secili modul duhet të ketë një fletë përmbledhëse të detyrave.

p.sh.:

Nr.	StudentID	Emri	Mbiemri	G	(10%) Detyra	(10%) Detyra	(10%) Detyra	(20%) Kollokvium	(50%) Provimi Final	Total	Nota	
1	18####K	#####	#####	B	15	10	0	58	40	34.1	5	Mungon
2	18####K	#####	#####	A	20	70	0	67	63	53.9	5	Mungon
3	18####K	#####	#####	C	3	100	85	83	70	70.4	8	Refuzo
4	18####K	#####	#####	C	15	100	50	79	77	70.8	8	Refuzo
5	18####K	#####	#####	C	70	75	90	79	85	81.8	9	E Refuzuar
6	18####K	#####	#####	C	0	0	0	63	0	12.6	0	Ka Munguar

* Pikët 100% * Pesha e pikëve në notimin përfundimtar

Kur dorëzohen detyrat?

Kjo varet prej lëndës. Normalisht duhet të llogaritet koha e mjaftueshme për realizimin e detyrës. Në syllabuset e lëndëve përcaktohet qartë se kur jepet detyra dhe kur dorëzohet ajo.

A duhet të gjitha detyrat të shkruhen me kompjuter?

Të gjitha detyrat duhet të shkruhen me kompjuter. Prandaj është e rëndësishme që studentët të mësojnë shkathtësitë kompjuterike të nevojshme për dorëzimin e detyrave. Këto mbulohen në shkathtësi akademike dhe biznesore. Poashtu, studentët duhet të kujdesen që të ruajnë detyrën dhe ta dorëzojnë atë me kohë.

Çka duhet të kem parasysh kur bëj një detyrë?

Shumica e detyrave kërkojnë nga ju që t'i lexoni para se t'i shkruani ato. Kjo do të thotë që ju shkruani për gjërat që i keni lexuar duke i referencuar ato dhe në të njëjtën kohë jepni idetë apo zgjidhjet tuaja.

Si e dorëzoj detyrën?

Dorëzimin e detyrës e përcakton profesori i lëndës, Ju e dorëzoni detyrën tek koordinatori i programit përkatës, në datën e caktuar apo e ngarkoni atë në e-learning. Aty nënshkruani një formë të dorëzimit, kopjen e të cilës e mbani për vete në rast se humb. Poashtu, është e rëndësishme që të mbani një kopje të detyrës së dorëzuar për vete deri sa të përfundojë lënda.

Çfarë ndodh nëse nuk e dorëzoj detyrën?

Nëse nuk e dorëzoni detyrën me kohë, ju automatikisht humbni përqindjen e paraparë për atë lëndë. Ju duhet të keni kujdes dhe të lexoni syllabusin e lëndës sepse në disa raste, leja për të hyrë në provim varet nga fakti se a e keni dorëzuar detyrën. Në të gjitha rastet, mënyra e riprovimit përcaktohet në syllabusin e lëndëve. Është e rëndësishme që ju të dorëzoni detyrat sipas afateve sepse ato ndihmojnë mësimin sistematik dhe përvetësimin e lëndës, me kohë dhe përpjekje normale. Rezultatet nga detyra poashtu janë indikator i rëndësishëm se në cilat pjesë keni përparuar apo ngecur dhe mund të ju ndihmojnë në përgatitjen e provimit final. Në rast të pamundësisë për dorëzimin e detyrës për shkaqe të jashtëzakonshme, ju duhet të njoftoni profesorin, departamentin dhe të dorëzoni evidencë për një gjë të tillë.

Kur i pranoj rezultatet e vlerësimit?

Pasi që kryeni një element vlerësimi, mësimdhënësit do ta vlerësojnë atë. Mësimdhënësi e bën vlerësimin brenda dy javëve prej realizimit të provimit. Por kjo varet edhe nga lloji i vlerësimit. Posa të përfundojë vlerësimi, ju do të njoftoheni për të. Notat ju mund t'i shihni të publikuara në MIS apo përmes e-mailit.

Si i pranoj komentet në performancën time?

Secili mësimdhënësi është i obliguar të mbajë konsultime dhe të ofrojë komente me shkrim për performancën tuaj në lëndë. Kjo do të ju ndihmojë juve që të mësoni se ku duhet të koncentrohemi më shumë për të përparuar në lëndë.

A pajsem me kopjen e vlerësimit?

Jo, por ju mund ta shihni provimin, detyrën tuaj gjatë konsultimeve grupore apo individuale dhe do të merrni vlerësimin për detyrën apo provimin tuaj. Kopja mbahet në dosjen tuaj për një vit akademik dhe pastaj shkatërrohet.

Çfarë është sistemi i vlerësimit?

Përqindja e vlerësimit ndërtohet nga elementet e vlerësimit. Në vijim keni sistemin e vlerësimit të aplikueshëm në Kolegjin Riinvest.

Nota	Nr i orëve për Aktivitetin	Përqindja totale	Nota ECTS
10	Shkëlqyeshëm	90-100	A
9	Shumë mirë	80-89	B
8	Mirë	70-79	C
7	Kënaqshëm	60-69	D
6	Mjaftueshëm	50-59	E
5	Dobët	0-49	FX/F

Çka ndodh nëse nuk e kaloj lëndën?

Studenti obligohet të kalojë lëndën me sukses pas tri (3) nënshtrimeve në provim. Nëse studenti nuk i nënshtrohet provimit në lëndën e caktuar në afatin e dhënë, atëherë i llogaritet që ka shpenzuar afatin e rregullt ose kompensues të ofruar. Nëse pas tri afateve të provimit studenti nuk kalon lëndën, atëherë ai obligohet të dëgjojë sërish lëndën në vitin vijues akademik. Pagesa e vitit akademik përsëritës do të jetë në proporcion me provimet e mbetura (shih nenin 13, në Rregulloren e studimeve BA). Për regjistrimin e vitit vijues, studenti duhet të ketë minimum 39 kredi të dhëna nga viti paraprak, pas nënshtrimit në afatin e fundit. Kjo do të thotë që kur bëhet regjistrimi i vitit të dytë, studenti duhet të ketë 4 provime të dhëna dhe kur bëhet regjistrimi i vitit të tretë, të ketë minimum 11 provime të dhëna (shih nenin 14, në Rregulloren e studimeve BA).

Tarifa për Përsëritjen e Lëndës është ndryshuar me vendim të bordit, prej kalkulimit për kredi, në një çmim fiks, të reduktuar në 50 euro për provim.

Çka është Plagjiatura dhe Mashtrimi?

Plagjiatura është term që definohet në shumicën e fjalorëve dhe referencave bibliotekë, si paraqitjen e ideve, punës kreative apo fjalëve të një personi nga ana e një personi tjetër, si të tij, pa e bërë të njohur atë. [Pears & Shields, 2005]

Sipas përvojave shkencore dhe akademike, plagjiatura përveç veprimeve tjera, përfshin më së shpeshti edhe veprimet në vijim:

- ✓ Parafrazimin e informacionit nga një burim pa e bërë të ditur origjinën e burimit dhe pa referencuar atë.
- ✓ Kopjimin dhe vënien e informacionit, grafikës apo ndonjë tjetër lloj të medias pa bërë të ditur burimin.
- ✓ Përdorimin e punimeve të dikujt tjetër apo blerjen e punimeve apo hulumtimeve të cilat vetë nuk i kanë bërë.
- ✓ Mos vënien e thonjzave kur citohet pjesë e një informacioni të cilin e kanë marrë plotësisht.

Për të evituar plagjiaturën, studentët duhet të konsultohen me profesorët për të gjitha paqartësitë, para se të dorëzojnë punimin. Studentët poashtu udhëzohen që të ndjekin udhëzimet zyrtare nga Kolegji Riinvest, në lidhje me referencimin dhe udhëzimet e profesorëve për punimet e tyre. Shih nenin 20, në rregulloren e studimeve bachelor.

Mashtrim konsiderohet nëse studenti kopjon gjatë testit apo provimit. Mashtrimi mund të bëhet në disa mënyra:

Kopjimi nga letra, libri (nëse ajo nuk është e lejuar me rregullat e provimit)

Marrja e rezultateve me gojë apo me shkrim nga kolegu/ja. Shih nenin 21, në rregulloren e studimeve bachelor.

Çfarë ndodhë nëse konstatohet plagjiatura?

Plagjiatura konsiderohet kopjimi në çdo gjë që vlerësohet brenda kolegjit. Plagjiatura trajtohet në kuadër të programit dhe dënohet sipas procedurave në vijim:

Nëse profesori konstaton që studenti/ja ka bërë plagjiaturë, ai/ajo njofton udhëheqësin e departamentit dhe aty konsiderohet nëse dërgohet në komisionin disiplinor.

Nëse studenti/ja përsërit për herë të dytë plagjiaturën, profesori e njofton komisionin disiplinor dhe komisioni ka të drejtë ta pezullojë me humbje të afateve ose me përsëritje të lëndës.

Kur studenti/ja përsërit për herën e tretë plagjiaturën, komisioni disiplinor rezervon të drejtën e përjashtimit nga programi. Procedura për trajtimin e rasteve të plagjiaturës është dhënë në Aneksin 4, në rregulloren e studimeve Bachelor.

Çfarë ndodhë nëse konstatohet mashtrimi?

Mashtrim konsiderohet kur studenti përdorë mënyra të ndryshme jo të lejueshme gjatë provimit, testimit, punimeve, prezantimeve. Mashtrimi trajtohet në kuadër të programit dhe dënohet nëse konstatohet sipas procedurave në vijim:

Nëse profesori konstaton që studenti/ja ka bërë mashtrim, ai/ajo njofton udhëheqësin e departamentit dhe aty vendoset nëse studenti/ja do të dërgohet në komisionin disiplinor.

Nëse studenti/ja përsërit për herë të dytë mashtrimin, profesori e njofton komisionin disiplinor dhe komisioni ka të drejtë ta pezullojë me humbje të afateve ose me përsëritje të lëndës.

Kur studenti/ja përsërit për herën e tretë mashtrimin, komisioni disiplinor rezervon të drejtën e përjashtimit nga programi. Procedura për trajtimin e rasteve të plagjiaturës është dhënë në Aneksin 5, në rregulloren e studimeve bachelor.

Linku për rregulloren e studimeve:

https://riinvest-edu.net/Uploads/Regulations/6/Rregullorja-e-Studimeve-BA_BSc.pdf

Kë duhet të kontaktoj kur kam ndonjë pyetje?

Si student i Kolegjit Riinvest, pika e parë e kontaktit është Zyra për Shërbime Studentore. Por, në rast se keni nevojë të kontaktoni anëtarë të tjerë të kolegjit, kontaktet e tyre i keni në fillim të këtij doracak.

Si mund të ankojem?

Studentët kanë të drejtë të shfaqin pakënaqësitë e tyre mbi ligjërimin, ushtrimet dhe vlerësimin e marrë nga mësimdhënësi përkatës, duke kërkuar formën në Zyrën për Shërbime Studentore dhe e njëjta dorëzohet në Zyrën për Shërbime Studentore, në afat prej 3 ditësh, pas komunikimit të rezultateve. Procedura e Ankimimit dhe shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave është rregulluar në rregulloren e studimeve Bachelor. Në rast të ankesës, ju mund të kërkonti kopjen e detyrës apo provimit dhe ajo do të ju dorëzohet. Formularin për ankesë mund ta kërkonti nga Zyra për Shërbime Studentore.

A ka ndonjë mekanizëm për pjesëmarrjen e studentëve?

Po, studentët marrin pjesë në të gjitha proceset akademike. Unioni i studentëve krijohet nga studentët e Kolegjit Riinvest dhe ata përgatisin zgjedhjet e studentëve, ku zgjedhen përfaqësuesit e tyre.

Studentët marrin pjesë në:

- Këshillin Akademik
- Këshillin e Programeve
- Komisionet Përkatëse

Si mund të bëj komentet për përvojën time në Kolegj?

Sa herë që keni vërejtje, ju mund ta adresoni këtë me udhëheqësin e departamentit. Nëse ju nuk mund ta bëni këtë, atëherë mund të bisedoni me tutorin personal me të cilin flisni në konfidencë. Ju poashtu do të keni mundësi të komentoni në formularët e vlerësimit për secilën lëndë veçmas, si dhe në formularët për organizimin e kolegjit dhe shërbimet. Poashtu, përfaqësuesit tuaj studentorë mund të paraqesin çfarëdo brenga të studentëve në organet përkatëse.

Procedura e ankesave

Studentët kanë të drejtë të shfaqin pakënaqësitë e tyre mbi vlerësimin e marrë nga mësimdhënësi përkatës apo për ndonjë shkelje tjetër që supozohet që ju është bërë nga personat zyrtarë dhe organet e kolegjit, duke bërë një ankesë e cila drejtohet tek komisioni i ankesave në afat prej 3 ditë pas komunikimit të rezultateve apo mos shkeljes së supozuar. Procedura e ankesës dhe shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave është në vijim.

Të gjitha ankesat duhet të zgjidhen në mënyrë të dyanshme nëse është e mundshme. Studentët udhëzohen që të diskutojnë hapur çështjen që u përkasin lëndëve me profesorin e lëndës.

Nëse studentët nuk mund të zgjedhin çështjen e caktuar me profesorin e lëndës, atëherë ata mund të parashtrorin një ankesë formale.

Studenti parashtron ankesën formale në formën e caktuar që e merr tek administrata apo në uebfaqe.

Studentët dorëzojnë ankesën brenda tre ditëve prej kohës kur merr notimin apo prej ditës kur bëhet veprimi i shkeljes së supozuar tek administrata e BPrAL Riinvest. Administrata është e obliguar t'i lëshojë studentit dëshminë e dorëzimit të ankesës.


Lënda dërgohet tek Komisioni i ankesave. Udhëheqësi i programit dhe personi ndaj të cilët është shtruar ankesa njoftohen për formën dhe natyrën e ankesës.

Administrata njofton studentin me shkrim për vendimin e komisionit dhe me rekomandimet e tij brenda 5 ditëve prej shqyrtimit të rastit.

Udhëheqësi i programit fton Komisionin për shqyrtimin e ankesave brenda 15 ditëve dhe fton studentin të marrë pjesë bashkë me një student tjetër apo të afërm. Një kopje e procedurës ankimore dhe rregullores duhet t'i jepen studentit paraprakisht.

Administrata arkivon procedure dhe njofton menaxhmentin për rezultatet e procedurës.

Procedura per Plagjiature dhe Mashtrim



RREGULLAT GJATË PROVIMEVE

Kolegji Riinvest vendos kohën e provimeve në tabelat e shpalljes dhe në web faqe. Studentët duhet të vijojnë provimet sipas orarit të caktuar. Të gjithë studentët duhet të lexojnë këto rregulla të cilat vlejnë për të gjitha provimet dhe institucioni konsideron që studentët i kanë lexuar ato.

- ✓ Është përgjegjësi e studentit të dijë datën e saktë të provimit, vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit. Nëse studentët nuk janë njoftuar me orarin e provimeve, ata duhet të kontaktojnë administratën.
- ✓ Nëse studentët kanë ndonjë aftësi të kufizuar, është përgjegjësi e tyre ta deklarojnë atë tek Zyra për Shërbime Studentore, e cila pastaj e dorëzon çështjen për trajtim të veçantë.
- ✓ Studentët fillojnë të hynë në klasë 15 minuta para se të fillojë provimi, sipas udhëzimeve të administratorit. Studentët nuk mund të hynë në provim pas fillimit të provimit.
- ✓ Studentët duhet të kenë me vete kartën e studentit në secilin provim dhe ta vendosin atë në tavolinë. Administratori / kujdestari i provimit do të kontrollojë kartat dhe listën e studentëve të pranishëm në provim.
- ✓ Gjatë provimit, studentët duhet të dëgjojnë udhëzimet e administratorit të provimit dhe ta njoftojnë atë nëse nuk mund t'i dëgjojnë apo nuk mund t'i kuptojnë udhëzimet.
- ✓ Studentët duhet të marrin vetëm pajisjet të cilat janë të lejuara në provim dhe ato duhet të përcaktohen nga bartësi i lëndës.
- ✓ Nëse nuk është ndryshe e specifikuar, studentët mund të marrin në provim vetëm laps kimik.
- ✓ Nuk është e lejuar të merret në provim asnjë mjet tjetër, duke përfshirë telefon mobil, i-phone, i-pod, letër. Këto gjëra duhet të dorëzohen tek administratori para uljes në bankë.
- ✓ Studentët nuk mund të marrin as fjalorë dhe libra, përveç nëse një gjë e tillë është lejuar nga profesori dhe është specifikuar në informatën për provim.
- ✓ Studentët poashtu duhet të lënë çantat dhe palltot tek vendi i përcaktuar nga administratori.
- ✓ Studentët duhet të plotësojnë informatat identifikuese sipas udhëzimit të administratorit.
- ✓ Të gjitha përgjigjet duhet shkruhen vetëm në fletët e ofruara nga administratori, me laps kimik dhe me shkrim të kuptueshëm.
- ✓ Studentët në asnjë mënyrë nuk duhet të flasin me kolegët e tyre gjatë provimit dhe nuk duhet të pengojnë mbarëvajtjen e provimit. Studentët mund të lënë klasën vetëm me lejen e administratorit dhe pa penguar të tjerët. Në fund të provimit, duhet të ruhet qetësia derisa të mblidhen të gjitha provimet.
- ✓ Ndalohen pijet dhe ushqimi.
- ✓ Studentët nuk duhet të përdorin mjete apo metoda mashtrimi gjatë provimit. Këto përfshijnë kopjimin nga një student tjetër, falsifikimin, përdorimin e mjeteve të paautorizuara në provim, si letër, pajisje dhe libra.

Kalendari Akademik 2021-2022

Kalendari Akademik 2021-2022

Muaji	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime
						2	3				
Tetor	4	5	6	7	8	9	10				Java orientuese për studentët Bachelor
	11	12	13	14	15	16	17	Week 1		Java 1	Fillimi i semestrit dimeror për studentët Bachelor dhe LSE Year II and III
	18	19	20	21	22	23	24	Week 2		Java 2	Fillimi i semestrit dimeror për studentët Master (Viti II)
	25	26	27	28	29	30	31	Week 3		Java 3	
	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime
Nëntor	1	2	3	4	5	6	7	Week 4	Week 1	Java 4	Start of semester for LSE Students (Year 1)
	8	9	10	11	12	13	14	Week 5	Week 2	Java 5	
	15	16	17	18	19	20	21	Week 6	Week 3	Java 6	Fillimi i semestrit dimeror për studentët Master (Viti I)
	22	23	24	25	26	27	28	Week 7	Week 4	Java 7	Afati i jashtëzakonshëm i provimeve - Nëntor 2021
	29	30						Week 8	Week 5	Java 8	
	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime
Dhjetor			1	2	3	4	5	Week 8	Week 6	Java 8	
	6	7	8	9	10	11	12	Week 9	Week 7	Java 9	
	13	14	15	16	17	18	19	Week 10	Week 8	Java 10	
	20	21	22	23	24	25	26		Week 9	Java 11	
	27	28	29	30	31						Krishtlindjet Katolike (25.12.2021) - Pushimi dimeror
	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime
Janar						1	2				
	3	4	5	6	7	8	9				Viti i Ri (01 dhe 02 Janar) / Krishtlindjet ortodokse - Pushimi dimeror
	10	11	12	13	14	15	16	Week 11	Week 10	Java 12	Start of semester for LSE Students (Year 2 and 3)
	17	18	19	20	21	22	23	Week 12		Zevesi	
	24	25	26	27	28	29	30	Week 13		Zevesi	
	31							Week 14		Zevesi	
	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime
Shkurt		1	2	3	4	5	6	Week 14	Week 11		Start of semester for LSE Students (Year 1)
	7	8	9	10	11	12	13	Week 15	Week 12		
	14	15	16	17	18	19	20	Week 16	Week 13		Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës / Afati i provimeve Shkurt/Mars 2022
	21	22	23	24	25	26	27	Week 17	Week 14		Afati i provimeve Shkurt / Mars 2022
	28							Week 18	Week 15		
	H	M	M	E	P	S	D	JAV VALSE	JAV ALSE (Year 1)	JAV A	Shenime

	H	M	M	E	P	S	D	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Prill					1	2	3		Week 9	Java 4	
	4	5	6	7	8	9	10		Week 10	Java 5	Pashkët Katolike
	11	12	13	14	15	16	17			Java 6	Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (09.04.2022)
	18	19	20	21	22	23	24			Java 7	Afati i jashtëzakonshëm i provimeve - Prill 2022
	25	26	27	28	29	30				Java 8	

	H	M	M	E	P	S	D	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Maj							1				
	2	3	4	5	6	7	8			Java 9	Dita Ndërkombëtare e Punës (01.05.2022) / Pashkët Ortodokse / Fiter Bajrami
	9	10	11	12	13	14	15			Java 10	Dita e Evropës
	16	17	18	19	20	21	22			Java 11	
	23	24	25	26	27	28	29			Java 12	
	30	31								Zevendësi	

	H	M	M	E	P	S	D	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Qershor			1	2	3	4	5			Zevendësi me	
	6	7	8	9	10	11	12				
	13	14	15	16	17	18	19				
	20	21	22	23	24	25	26				Afati i provimeve Qershor / Korrik 2022
	27	28	29	30							

	H	M	M	E	P	S	D	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Korrik					1	2	3				
	4	5	6	7	8	9	10				Afati i provimeve Qershor / Korrik 2022
	11	12	13	14	15	16	17				Kurban Bajrami
	18	19	20	21	22	23	24				
	25	26	27	28	29	30	31				

	H	M	M	Ej	Pr	S	Di	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Gusht	1	2	3	4	5	6	7				
	8	9	10	11	12	13	14				
	15	16	17	18	19	20	21				
	22	23	24	25	26	27	28				
	29	30	31								

	H	M	M	Ej	Pr	S	Di	JAV AL SE	JAV AL SE (Year 1)	JAV A	Shenime
Shtator				1	2	3	4				
	5	6	7	8	9	10	11				
	12	13	14	15	16	17	18				Afati i provimeve Shtator 2022
	19	20	21	22	23	24	25				
	26	27	28	29	30						

Shënim: Data e festave zyrtare (Bajrami/Pashkët) mund të ndryshojnë sipas kalendarit hënor. Ne rast se do të këtë ndryshime do të viheni në dijeni me një njoftim te dytë.